



Datë: 02.02.2026
Numër Protokolli: 587/2026

A.nr.61/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.61/2026, të datës 21.01.2026, të parashtruar nga ankuesi K.H, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kontest nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2026, nxjerrë, këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.61/2026 të datës 21.01.2026, e parashtruar nga ankuesi K.H.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil K.H (*më tej referuar vetëm* Ankuesi), me datë 21.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 48/2026 të datës 14.01.2026, të Sekretarit të Përgjithshëm të MPB për Transferimin e përkohshme të nëpunësit civil, ndërsa, ankuesi më datë 30.01.2026, ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës të datës 21.01.2026, duke mos specifikuar ndonjë arsye konkrete të tërheqjes.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankuesit për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.61/2026 të datës 21.01.2026.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.61/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit K.H;
- Njesisë se Burimeve Njerëzore të MPB dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.